



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilijeno Më/Dana <u>08-02-2012</u>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
	<u>01-013/129</u>		

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2012, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN DHE CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN
E OBJEKTIT KOLEKTIV PËR FAMILJET E PA STREHË

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë NDAN dhe cakton një lokacion në pasurin e paluajtshme (tokën) pasuri shoqërore e Komunës së Vitisë e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 2497-11, lloji i pronës parcelë, zona u/r Urban, vendi i quajtur "Selishte Lozhiq", me sipërfaqe prej 1550m2 Zona Kadastrale Viti, për ndërtimin e objektit kolektiv për familjet e pa strehë në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Ndarja e lokacionit për ndërtimin e objektit kolektiv në pasurinë e paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën verbale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Viti, drejtuar Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Mjetet financiare për ndërtimin e këtij objekti do të siguroj Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Republikës së Kosovës, ndërsa Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet të bëjë ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim kolektiv për familjet e pa strehë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01. Nr _____
Viti, 08.02.2012

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Drejtorisë për Shëndetësi
3. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E T A R I
Skenderbe Hebibi



Skenderbe Hebibi